REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË – DEVOLL – KOLONJË

Nr. 4401 Prot.

Korçë, më 25.6.2026

Lënda: Kërkesë për afishim dhe bashkëpunim.

BASHKIA MALIQ
Zyra e Protokollit
Nr. 4031 Prot.
Date 29.6.26

BASHKISË MALIQ

NJËSISË ADMINISTRATIVE **LIBONIK**
GORË
MOGLICË
VRESHTAS
MALIQ
PIRG
POJAN

Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë – Devoll – Kolonjë në zbatim të Ligjit 20/2020 *"Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"* është duke proçesuar mbi praktikat e dosjeve të legalizimit për objektet informale të ndodhura në territorin që ka në kompetencë Institucioni juaj.

Gjatë proçesit të evidentimit faktik në terren në zbatim të VKM-së 1178, datë 24.12.2020 " *Për përcaktimin e dokumentacionit dhe regullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje*" nga grupet e specialistëve të terrenit është konstatuar që në një numër të konsiderueshëm ndërtime informale ka qënë e pamundur të kryheshin matjet fizike në terren të objektit, përditësimi i gjendjes ndërtimore për faktin se poseduesit nuk ndodheshin në objektet e tyre.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me qëllim finalizimin e procedurave administrative të legalizimit të ndërtimeve informale, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se gjatë muajve korrik–gusht vihet re një rritje e numrit të shtetasve emigrantë që kthehen përkohësisht në vendin e tyre, kërkojmë bashkëpunimin tuaj për informimin sa më të gjerë të qytetarëve të interesuar. Për këtë qëllim, lutemi të merrni masat për:

I. **Publikimin e këtij njoftimi për një afat 60 (gjashtëdhjetë) ditor në ambientet e institucionit tuaj, në vende të dukshme dhe të aksesueshme për publikun.**